

## FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

### **A- Për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”.**

1. Do të pranohen në ciklin e parë të studimeve “**Bachelor**” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm e të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas VKM Nr. 407, dt. 01/06/2016.
2. Kandidatët janë të detyruar t’i nënshtrohen konkurimit praktik sipas testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen Web të UST.
3. Kanë të drejtë të konkurojnë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjeksore të miratuar nga UST-ja dhe të shpallur në Web të UST-së.

### **B- Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”, “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”.**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “**Master Profesional**” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “**Bachelor**” pranë FSHL- apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen Web të UST-së.
3. Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin “**Bachelor**” në sistemin Full – Time dhe Part – Time pranë FSHL-së.
5. Në rast se do të rezultojnë vende të mbetura bosh do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “**Bachelor**” në IAL-ët e tjera brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare sipas rendit zbritës.

### **C- Për ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”**

- 1.** Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë **“Master Shkencor”** kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë **“Bachelor”** pranë FSHL-së apo IAL të tjera të ngjashme me të.
- 2.** Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë **“Master Shkencor”** kandidatët që kanë përfunduar me sukses mbrojtjen e një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1 sipas shkresës nr. 3228 Prot, dt. 23.03.2018 të MASR.
- 3.** Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen Web të UST.
- 4.** Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare.